



*Shoqata Iniciativa e Grave
në Bresane (Komuna e Dragashit)*

RAPORTI FINAL I VLERËSIMIT

Vlerësim i Jashtëm i Fondit të Grave të Kosovës

Ekipi i Konsulenteve	Shevolution & Hieros International AB
Klienti:	Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK)
Periudha e Aktiviteteve :	7 shkurt -15 prill 2014
Data e dorëzimit:	15 prill 2014

1. Përmbledhje ekzekutive

1.1 Hyrje

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK), që nga viti 2000 punon në fuqizimin e gruas. Ai është rritur në një rrjet të konsiderueshëm të përbërë prej 77 organizatave anëtare, duke u bërë kështu një nga aktorët kryesor dhe më të respektueshëm të shoqërisë civile në Kosovë.

Në vitin 2012, RrGGK, në konsultim me anëtarët e vet dhe me mbështetje nga Fondi Kvinna till Kvinna (KtK), ka themeluar Fondin e Grave të Kosovës (FGK). Fondi ofron grante të vogla dhe ngritjen e kapaciteteve për organizatat e grave të cilat përballen me mungesë të qasjes në burimet e financimit dhe ka për synim zhvillimin e mëtejshëm të drejtave të grave, posaçërisht në mesin e zonave rurale dhe/apo grupeve të marginalizuara¹. RrGGK ka ndërmarrë masa për të zvogëluar distancën mes OJQ-ve të mëdha dhe organizatave të vogla.

Duke dashur të ndërtojë mbi sukseset e mëhershme, Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) dhe KtK, së bashku kanë mbështetur Fondin përmes një projekti dy vjeçar (2012-2014) "Supporting, Protecting and Promoting the Rights and Interests of Women and Girls" (Mbështetja, Mbrojtja dhe Promovimi i të Drejtave dhe Interesave të Grave dhe Vajzave).

Kjo lidhet me kontekstin e asaj që RrGGK dhe mbështetësit e tij, KtK dhe ADA, kanë vendosur që të bëjnë një vlerësim të jashtëm të Fondit për të vlerësuar progresin e arritur deri më tani dhe për t'i identifikuar nevojat për të ardhmen. Ky vlerësim i jashtëm është financuar nga KtK-ja.

1.2 Qëllimi dhe kufizimet

Në fillim të vlerësimit, u diskutua për qëllimin dhe kufizimet e vlerësimit dhe është arritur pajtim mes RrGGK, KTK dhe ADA.

Vlerësimi është bërë në mes të projektit kështu që rekomandimet e dala mund të përdoren për t'u informuar lidhur me iniciativat që janë në zhvillim e sipër e që lidhen me Fondin. Vlerësimi shqyrton shkallën në të cilën janë arritur rezultate, duke pasur parasysh se projekti i tanishëm është në gjysmë të rrugës.

Përmes këtij vlerësimi synohet të gjendet ndikimi i FGK-s (p.sh. ndikimi i FGK-s në nivel të familjeve, në nivel lokal dhe atë Komunal si dhe për ndikimin që ai mund të ketë, nëse do të vazhdohej, në promovimin e barazisë gjinore dhe të drejtave të grave), efektiviteti (sa ia ka arritur projekti të përmbush qëllimet e caktuara dhe mundësinë e të qenit i qëndrueshëm) dhe efikasitetin e deritanishëm si dhe propozimin e rekomandimeve në drejtim të forcimit të kapaciteteve të Fondit dhe të RrGGK për të *menaxhuar atë në të ardhmen*". *Termt e Referencës (TOR) për këtë vlerësim janë bashkëlidhur si Shtojca I.*

Deri në një shkallë të caktuar, ky vlerësim në mes të projektit vlerëson ndikimin që ka pasur projekti por që nuk është vlerësim i ndikimit. Fondi tanimë ekziston për gati dy vjet (2012-2014) dhe mund të mos ketë pasur kohë të mjaftueshme për të vërejtur ndikimet afatgjata dhe ndryshimet në masë të gjerë të shoqërisë. Vlerësimi nuk ka të bëjë me Grupet e Avokimit për Barazi Gjinore² (GABG) e as nuk bënë ekzaminimin e financave të FGK-s të cilat janë audituar në mënyrë të pavarur. Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) do të bëjë një vlerësim të veçantë të FGK-s duke përfshirë edhe rezultatet dhe të arriturat e Grupeve të Avokimit për Barazi Gjinore (GABG).

¹Gratë e marginalizuara siç janë gratë në zona rurale, kryefamiljaret, gratë e pashkolluara, të varfra, gratë me aftësi të kufizuara dhe ato nga minoritetet si ai Rom, Ashkali, Egjiptas, Goran, Turk dhe Serb përbëjnë përfitueset kryesore dhe grupet e synuara të Fondit të Grave të Kosovës.

² Grupet e Avokimit për Barazi Gjinore i bashkojnë gratë në politikë dhe ato nga shoqëria civile, në përpjekje për të avokuar për të drejtat e grave si dhe për barazi të grave në nivel komunal. (Raporti Vjetorë i RrGGK 2012)

1.3 Përmbledhje e metodologjisë

Përtej studimit të bërë nga zyra, nga ana e Ekipit të Konsulentëve, mes datës 8 dhe 14 mars 2014, janë ndërmarrë edhe studime dhe vizita në terren. Metodologjia detale dhe lista e personave dhe organizatave që janë takuar janë dhënë në *Shtojcat II dhe III*.

Ekipi pati mundësinë që të vizitojë tetë lokacione në Kosovë dhe të takohet me 36 organizata. Kjo nuk është e mjaftueshme për të gjeneralizuar aktivitetet e FGK-s si tërësi por megjithatë mundet që të ofrojë një kuptim për iniciativat e Fondit si dhe shembuj konkret të aktiviteteve, të arriturave dhe sfidave të ndryshme.

Dëshirojmë të shfrytëzojmë rastin që të falënderojmë të gjithë ata që kanë kontribuar në këtë raport duke na ofruar informata, mendime, ide dhe mbështetje praktike. Posaçërisht dëshirojmë të falënderojmë RrGGK-n, KtK- dhe ADA-an në Kosovë për pritjen e shkëlqyeshme që na e kanë bërë dhe për gatishmërinë që të takohen me ne.

1.4 Efektiviteti i projektit

Ky seksion mat shkallën në të cilën projekti arrin qëllimin e tij ose, në bazë të rezultateve të dala, nëse mund të pritët të ndodhë një gjë e tillë, Në kuadrin e kriterëve të efektivitetit përfshihen edhe afatet kohore.

Menaxhimi i Projektit

Janë vërejtur përmirësime të dukshme sa i përket hartimit të propozimeve. Fituesit e granteve të FGK-së kanë thënë se para një intervenimi të tillë, ato kanë pasur kufizime në të kuptuarit apo nuk kanë ditur fare për menaxhimin e projekteve. Për më tej, ato kanë thënë se ky Projekt “u ka hapur sytë” lidhur me dokumentacionin e ndryshëm si ato për raportet përmbledhëse dhe financiare dhe se në thelb u ka hapur mendjen sa i përket ciklit të menaxhimit të projekteve. Shkathtësitë dhe njohuritë e arritura lidhur me menaxhimin e projekteve kanë quar drejt përmirësimit të aftësive të planifikimit dhe ngritjes së fondeve deri në atë shkallë sa që disa përfitues të granteve iu kanë drejtuar donatorëve tjerë për financime. Ky projekt iu ka mundësuar këtyre organizatave të grave të kenë besim dhe kontroll më të madh në rrugëtimin e mëtejshëm të tyre.

Pjesëmarrja në vendimmarrje dhe avokim

Objektiva e definuar e projektit për rritjen dhe avancimin e pjesëmarrjes së gruas në avokim është përqendruar kryesisht në proceset e vendimmarrjes në nivel komunal dhe është brenda afatit. Decentralizimi i para do kohe ka nënkuptuar edhe bartjen e përgjegjësisë nga niveli qendror në atë komunal. Komunitat gradualisht po marrin kompetenca më të mëdha për shërbimet që u ofrohen qytetarëve.

Qëllimi i përfshirjes së grave nga zonat më të marginalizuara në proceset e vendimmarrjes ka treguar të jetë efektiv. Përfitueset e granteve nga FGK-ja kanë marrë pjesë në vendimmarrje gjatë takimeve në RrGGK-s dhe kanë lobuar e bashkëvepruar me aktorët kryesor në vijim për të mbrojtur të drejtat e grave në komunitetin ku ato jetojnë: me kryetarët e komunave, kuvendin komunal, zyrtarët komunal për barazi gjinore, drejtoritë për shërbimet publike, drejtoritë për shëndetësi, shkollat publike dhe media.

Nganjëherë është e pamundur që të vlerësohet gjithë efektiviteti afatgjatë i avokimit kur fushatat për avokim janë në veprim për një kohë të shkurtër. Organizatat e mbështetura nga FGK-ja në përbërjen e vet kanë gra me njohuri të thella për çështjet që duhet të adresohen në komunitetin e tyre por shpesh me përvojë të pakët apo pa përvojë paraprake në avokimin e politikave publike. Për shumë kë në grupet e synuara të FGK-s, avokimi qytetarë për politikave publike është një koncept i ri. Për disa gra është hera e parë që kanë marrë pjesë në takime jashtë shtepive të tyre. Megjithatë, Konsulentet kanë vërejtur gjatë takimeve dhe intervistave se FGK iu ka mundësuar dhe i ka fuqizuar këto gra nga grupet e marginalizuara që të takohen, të diskutojnë për çështjet që i prekin ato, të mësojnë t’i shprehin mendimet e tyre, të mësojnë për të drejtat e tyre si dhe të fillojnë t’i zhvillojnë aftësitë që t’i shprehin prioritetet e tyre verbalisht para grupeve të njerëzve. Këta janë hapat e parë të rëndësishëm drejt avokimit të politikave publike.

Duke u bazuar në trajnimet dhe mentorimet e ofruara nga stafi i RrGGK-s, avokimet e ndërmarra kanë kontribuar në ndryshimet e politikave lokale, duke përfshirë buxhetet komunale (ri-alokimi i fondeve për përfitim të një numri më të madh të grave në komunitetet e tyre) dhe anëtarësimin e një përfaqësueseje të organizatave të personave më aftësi të kufizuara në këshillin komunal.³

1.5 Ndikimi dhe rezultatet e projektit

Ky seksion merret me efektet më të gjera të projektit – ato sociale, ekonomike, teknike, mjedisore – efektet në individët, ato gjinore, grup-moshat, komunitetet dhe institucionet. Ndikimet mund të jenë të qëllimshme dhe të paqëllimshme, pozitive dhe negative, të mëdha (sektoriale) dhe të vogla (familjare). Ky seksion vlerëson ndikimin e qëllimshëm dhe të paqëllimshëm të iniciativave të përfitueseve të granteve të FGK-s në përfituesit e tyre në nivel të familjeve, në nivel lokal dhe atë komunal. Kjo përfshin vlerësimin se deri në çfarë mase iniciativat e tyre kanë kontribuar për të çuar më tej të drejtat e grave.

Grupet e marginalizuara, ato rurale dhe të minoriteteve janë të përfaqësuara mirë brenda përfitueseve të projektit. Konsulentet janë takuar me grupet e FGK-s të cilat (përveç tjerash) përfshijnë pensioniste të cilave iu është ofruar ekzaminimi dhe trajtimi i osteoporozës, gratë e reja nga zona rurale nga komuniteti Goran të cilat janë duke u trajnuar për aftësim ekonomik – dizajn dhe prodhim të veshjeve të modës, gratë të cilat janë dhunuar gjatë luftës dhe një grua lidere nga enklava serbe e cila punon me gratë të cilat kanë përjetuar dhunë familjare.

Për organizatat përfituese të granteve ndikimi ka të bëjë me avancimin e kapaciteteve për menaxhimin e granteve dhe ndërmarrjen e iniciativave avokuese me njohuritë e fituara për shfrytëzimin e disa instrumenteve menaxhuese si teknikat e RBM, M&E, librin e arkës, ciklin dhe strategjitë e avokimit.

Në nivel individual, respondentët e intervistuar kanë thënë se Projekti i FGK-s iu ka ndryshuar mënyrën e tyre të të menduarit dhe punës. Procesi i zhvillimit individual dhe në nivel organizativ ka filluar dhe janë ndryshuar proceset e punës. Trajnimi dhe monitorimi i ofruar në kuadrin e projektit ka hapur horizonte të reja për shumë nga ato, duke i inkurajuar disa prej tyre që t'u qasen donatorëve tjerë për fonde, duke filluar bizneset e veta, duke fituar respekt në rrethinën e tyre, duke iu falënderuar ngritjes së aftësive dhe fuqizimit të atyre që asnjëherë nuk ka dalë jashtë shtëpive/fshatrave të tyre. Përfitueset janë gra të pensionuara, të papunësuara, të pashkolluara, kryefamiljare, të reja, nga zonat rurale, minoritetet, personat e varfër dhe me aftësi të kufizuara.

Rritja e numrit të grave në procesin e vendimmarrjes e arritur si rezultat i Projektit, ka ndikim pozitiv në komunitet. Në total, deri më tani, 2,039 gra nga zonat rurale dhe grupet e marginalizuara kanë përfituar drejtpërdrejtë nga iniciativat e 34 përfitueseve të granteve të FGK-s. Në mënyrë indirekte, brenda komuniteteve të tyre, kanë përfituar edhe 1,500 njerëz. Mundësitë për ngritjen e kapaciteteve kanë prekur 104 individë të organizatave anëtare të RrGGK-s. Trembëdhjetë (13) ndryshime janë bërë si rezultat i iniciativave avokuese të grave si: edukimi i nxënësve dhe mësimdhënësve për verbërinë, gjë e cila ka rezultuar në atë që dy shkolla janë të gatshme të pranojnë fëmijët e verbër për shkollim pranë institucioneve të tyre; një nga Komunitat ka punësuar një interpretues të gjuhë së shenjave në drejtorinë e shërbimeve publike për të ndihmuar personat e shurdhër në kuvendin komunal dhe në drejtorinë për shëndetësi; shërbimet komunale kanë përfshirë vizitat mjekësore falas për gratë nga minoritetet; gratë e reja janë ndihmuar të vizitojnë Kryetarin dhe t'i ngrisin çështjet me rëndësi për to; janë fuqizuar gratë nga zonat rurale që të përfshihen më shumë jashtë shtëpisë së tyre dhe në bizneset e veta; dhe një grup i grave, kryefamiljare nga Novobërda janë përfshirë në planin komunal buxhetor, etj.⁴

Një ndikim përfitues i paparamenduar është se përfitueset e granteve të FGK-s kanë marrë pjesë në avokimin efektiv të RrGGK-së në gjithë vendin, pjesërisht duke ofruar njohuritë bazë dhe mbështetje për të ndihmuar në hartimin e politikave sikurse Ligji Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve,

³Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës. "Lista e Iniciativave për Avokim."

⁴Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës. (2014). "Raporti i Progresit të Projektit". Raporti Vjetor i Progresit dorëzuar Agjencisë Austriake për Zhvillim më 28 shkurt 2014. / Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës. (2014). "Raporti Vjetor 2013".

Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjarëve të Tyre dhe në prezantimin zyrtar të Planit Veprues Kombëtar të Qeverisë së Kosovës për zbatimin e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të KB 1325 për Gratë, Paqen dhe Sigurinë.

Po ashtu është vërejtur se Projekti ka pasur ndikim të paparamenduar por i cili ka qenë pozitiv për stafin e RrGGK-s. Si rezultat i rolit mbështetës të RrGGK-s, Projekti i ka dhënë stafit të RrGGK-s një përvojë të çmueshme në menaxhimin dhe mentorimin e një Fondi. Ka pasur raste kur stafi i RrGGK-s ka përfituar në mënyrë jo të drejtpërdrejtë përmes trajnimit 6 mujor lidhur me teknikat M&V.

1.6 Rëndësia e projektit

Ky seksion përmbledh atë nëse projekti është në përputhje me nevojat dhe prioritetet vendore (si dhe me politikat e donatorit). Ekziston një lidhje e fuqishme mes çështjeve të projektit dhe lëmive kryesore të donatorit. Si ADA edhe KtK-s për prioritet kanë “përkrahjen e pjesëmarrjes aktive të gruas dhe grupeve të marginalizuara dhe në nevojë, në proceset politike dhe vendimmarrëse në shoqëri”.⁵

FGK është i rëndësishëm për politikat ndërkombëtare drejt arritjes së Qëllimeve Zhvillimore të Mileniumit (QZHM). Rritja e vëmendjes ndaj të drejtave të grave në mesin e grupeve të marginalizuara ndihmon në punën drejt arritjes së QZHM-ve. Disa grupe të FGK-s takojnë gra të cilat kanë fuqi të vogël në vendimmarrje në shtëpitë e tyre, kanë varësi ekonomike, pamundësi për shmangie nga dhuna në familje, kanë pasur pak apo aspak qasje në pjesëmarrje politike dhe civile. Për të arritur qëllimet e mileniumit, duhet bërë më shumë përpjekje për t’iu adresuar grupeve që arrihen me vështirësi sikurse grupet e grave të marginalizuara. Nëse këto grupe lihen prapa, atëherë do të rritet pabarazia dhe do të nënvlerësohet qëndrueshmëria e arritjeve të qëllimeve të mileniumit.

Fondi është i rëndësishëm për kontekstin e Kosovës në disa aspekte: Trajnimet dhe mentorimet e RrGGK-s me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes së gruas në vendimmarrje dhe avokim janë mëse të rëndësishme sepse pavarësisht nga një rritje e numrit të grave të zgjedhura gjatë zgjedhjeve të fundit nacionale dhe komunale, gruaja ende mbetet e pa përfaqësuar sa duhet në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në Kosovë. Deri me tani, gratë nga grupet e marginalizuara dhe nga zonat rurale kanë pasur shumë pak mundësi që të ndikojnë në vendimmarrje.

Me rëndësi është edhe zgjedhja e grupeve të synuara përfituese. FGK adreson një grup të lënë pas dore. RrGGK-ja ka identifikuar se edhe pse një numër i vogël i OJQ-ve më të mëdha të grave me aftësi të për të folur në gjuhën angleze ia arrijnë të kenë qasje në financimet nga donatorët, grupet e grave në zonat rurale dhe grupet e tjera të grave të marginalizuara kanë vështirësi në sigurimin e burimeve të mjaftueshme për iniciativat drejtë barazisë gjinore dhe të drejtave të gruas dhe se para FGK-s kanë pasur pak apo aspak zë lidhur me këtë.

Për të rritur mundësitë për grupet e marginalizuara të grave që të kenë qasje në financime në të ardhmen, Projekti i FGK-s është përqendruar në ngritjen e kapaciteteve të përfitueseve të granteve në hartimin e propozimeve, zbatimin e projekteve, monitorimin dhe raportimin e tyre duke përfshirë hartimin e raporteve narrative dhe raportimin financiar. Është supozuar që përfitueset e granteve nga FGK-ja mund të marrin fonde nga donatorët tjerë dhe të ndërmarrin iniciativat të avokimit. Deri në një masë një gjë e tillë ka ndodhur. P.sh. një përfituese e grantit nga FGK-ja, Rikotta, ka pasur vetëbesim që të aplikojë për donacione në USAID dhe në Ambasadën Gjermane⁶. Një përfituese tjetër nga FGK-ja ka pranuar grantin e dytë nga Fondi.

Stafi i RrGGK ka punuar ngushtë me përfitueset e granteve për të siguruar që të gjitha aktivitetet të jenë të ndërlidhura me nevojat dhe kontekstin e përfitueseve të granteve. Meqë ky ka qenë një projekt për ngritjen e kapaciteteve, theksi është vënë në trajnime dhe monitorime. Për të siguruar se shkathtësitë e fituara janë të rëndësishme për kontekstin në Kosovë, atëherë trajnimet dhe mentorimet janë ndërmarrë përmes formës së pjesëmarrjes, përmes një bilanci të mirë midis “teorisë në klasa” dhe praktikës. Qasja e “Mësimi përmes veprimit” ka rezultuar në një shkallë të lartë të ndjenjës së pronësisë nga ana e përfitueseve të granteve dhe anëtarëve tjerë të RrGGK-s. Softueri i prezantuar i Sistemit për Menaxhimin e Granteve (GMS) është i përshtatshëm për

⁵Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim (ADA). (2013). “Strategjia për Kosovën 2013-2020”.

⁶Intervista me Pranvera Bullaku, Kryeshefe Ekzekutive e Rikotta-s ‘Women’s Piazza’ më 11 mars 2014 në Prishtinë.

menaxhimin e Fondit dhe së voni është testuar dhe është vënë në funksion t'u siguruar sa i përket përshtatshmërisë së tij në lidhje me qëllimin e synuar.

1.7 Qëndrueshmëria

Ky seksion analizon qëndrueshmërinë dhe sfidat në nivele të ndryshme: individuale (p.sh. njohuritë, marrëdhëniet me organizatat dhe institucionet tjera), në nivel të organizatës, në nivel institucional, financiar dhe bashkëpunimi me palët e interesuara për përfitueset e granteve dhe projektet e tyre (që sipas përcaktimit janë iniciativa afatshkurtra), në nivel të propozimit të zgjidhjeve të mundshme.

Është e vështirë të nxirret ndonjë përfundim që mund të verifikohet lidhur me qëndrueshmërinë e Projektit të FGK-s sepse Fondi është relativisht i ri. Sidoqoftë, rezultatet e deritanishme të projektit janë vlerësuar se kanë mundësi të mira për të qenë i qëndrueshëm meqë ka përfshirë dhe fuqizuar grupet e marginalizuara të grave që të përfshihen në menaxhimin e grantit dhe në avokim.

Në nivel individual, gratë të cilat shumë rrallë kanë dalë jashtë shtëpive, përmes projektit kanë krijuar shoqëri me gra të tjera, kanë ndarë përvojat e tyre dhe kanë fituar njohuri që iu kanë ndihmuar në shtëpinë e tyre dhe kanë fituar respekt në komunitet. Ka ndodhur një ndryshim në marrëdhëniet familjare mes gruas, pjesëtarëve të familjes dhe pjesëtarëve të komunitetit.

Vlerësohet se organizatat përfituese të granteve do të jenë në gjendje të vazhdojnë me avokim pranë komunave me kusht që të mund të marrin fonde dhe mbajnë stafin dhe me kusht që RrGGK të rrit angazhimin e vet në ngritjen e kapaciteteve për avokim.

Avancimi i kapaciteteve në hartimin e propozimeve, menaxhimin e granteve dhe në zbatimin e projekteve është një rezultat i qëndrueshëm i dalë nga Projekti i FGK-s. Donatorët theksojnë se e kanë vërejtur një avancim caktuar në kualitetin e aplikacioneve të dorëzuara në raundin e 4-të krahasuar me tri raundet paraprake të aplikimeve për grante.

Përshtypja e përgjithshme e këtij vlerësimi është se organizatat përfituese të granteve kanë një prezencë të mirë në terren, bashkëpunim të mirë me anëtarët, rrjetin e komunitetit dhe me komuna.

1.8 Efikasiteti i zbatimit të projektit

Ky seksion bënë matjen e rezultateve – atyre cilësore dhe sasiore – të arritura si rezultat i të kontributeve. Në përgjithësi kjo kërkon krahasimin e qasjeve alternative ndaj arritjes së një rezultati, të shikohet nëse është përdorur qasja më efikase.

Analiza detale e efikasitetit duke përdorur çfarëdo vlerësimi ekonomik nuk ka qenë e mundur brenda fushëveprimit të këtij vlerësimi afatmesëm. Prandaj ky seksion bazohet në përvojën dhe mendimet e vlerësuesve, nga ajo që ato kanë lexuar, parë, dëgjuar dhe vërejtur. Efikasiteti është vlerësuar kryesisht nga këndvështrimi teknik (efikasiteti teknik dhe i brendshëm).

Natyrë pjesëmarrëse e trajnimeve ka siguruar mësimnxënien. Një qasje e tillë është konsoliduar përmes vizitave përcjellëse dhe monitoruese gjë e cila ka ndihmuar mësimnxënien dhe ka rritur perspektivën për qëndrueshmëri.

Mbështetja financiare që i është dhënë FGK-s ka rrjedhë nga burime të shumëfishta (dy marrëveshje të veçanta me donatorë) të paraqitura më poshtë.

Përkrahje e Fondit të Grave të Kosovës në Euro (duke përjashtuar kontributin në natyrë)

Donatori / Marrëveshjet	Periudha e Aktiviteteve	Buxheti Total €	Fondet e përgjithshme për Grante	Kostot aktuale (Fondet për Grante)	Fondet për Grante të mbetura

Kvinna till Kvinna*	Korrik-Dhjetor 2012	29,339	10,000	10,209	përmbyllur
Kvinna till Kvinna/bashkëfinancim	Janar 2013-Dhjetor 2014 (Bashkë financim)	67,937	40,000	19,136	20,864
Agjencia Austriake për Zhvillim/bashkëfinancim	dhjetor 2012-dhjetor 2014 (Bashkë financim)	280,800	80,000	37,326	42,674
Totali i fondeve për Grande në Euro			130,000	66,671	63,538

*Marrëveshja e Donatorëve është finalizuar dhe përmbyllur

Totali i granteve të alokuara në Euro	130,000
Totali i granteve të shpërndara në Euro (të gjitha marrëveshjet e donatorëve)	66,671
Totali i granteve të mbetura në Euro	63,538

Rreth €66,671 nga totali prej €130,000 i fondeve të alokuara për grante të vogla iu janë shpërndarë 34 përfitueseve të granteve të FGK-s. Një nga marrëveshjet e donatorëve është përfunduar dhe përmbyllur. Marrëveshja e donatorëve për bashkëfinancim (ADA/KtK) është ende e hapur. Afati për raundet e granteve është në përputhje me kontratën e nënshkruar me donatorë. Në raundin e katërt, kualiteti i aplikacioneve është avancuar dukshëm por, sasia e aplikacioneve ka rënë. Deri në prill 2014, 54% e granteve të vogla nga marrëveshja për bashkëfinancim e donatorëve ende nuk janë shpërndarë. Prandaj, ekziston mundësia që RrGGK-ja të kërkojë vazhdimin e afatit pas dhjetorit 2014. Stafi i RrGGK-s është duke monitoruar procesin për së afërmi, si duke i informuar donatorët lidhur me progresin e bërë.

Në raundin e 2 të granteve, Shoqata e të Shurdhërve në Prizren ka pasur vështirësi gjatë zbatimit të projektit dhe e ka kthyer shumën nga granti i vogël prej €1,132 (kontribut i ADA-s) për shkak të një mbikëqyrësi mashkull i cili nuk ka lejuar femrat përfituese që të marrin pjesë në aktivitetet ku janë adresuar testimi i kancerit të gjirit dhe qafës së mitrës. Stafi i RrGGK-s në mënyrë pro-aktive ka këshilluar koordinatoren femër që të gjejë zgjidhjen më të mirë për të shkuar më tej. Si rezultat i kësaj, koordinatores ka themeluar një shoqatë të re – Shoqata e Grave të Shurdhra të Prizrenit – duke sqaruar si vijon: “Kam dashur [gruaja e shurdhër] që të kem më shumë hapësirë meqë një hapësirë e tillë nuk është mundësuar në OJQ-n tjetër”. Çështja është ngritur me kohë dhe janë shmangur pasojat tjera.⁷ Fondet e mbetura do të shpërndahen gjatë raundit të ardhshëm të granteve të financuara nga ADA.

Sipas buxhetit të ADA-s, kostot administrative përbejnë deri në 8% të kostove totale të projektit. Kjo i referohet kostove të drejtorisë së RrGGK-s. Kostoja për menaxhimin e projektit për stafin⁸ e RrGGK-s, sipas buxhetit të ADA-s është 21% e kostos totale të projektit. Mbështetja teknike ka qenë pjesë e përgjegjësisë të stafit të RrGGK-s.

Për një projekt të ngritjes së kapaciteteve ku shumica e përfitueseve (përfitueset e granteve të FGK) janë jashtë Prishtinës, ekziston një supozim i arsyeshëm se koha e kaluar jashtë Prishtinës e Koordinatorës së Fondit të Grave të Kosovës është po aq e rëndësishme sa koha që e kalon në Prishtinë me qëllim që të shmang ndërprerjen e komunikimit me përfituesit fundor të iniciativave të FGK-s. Një nga mësimet kryesore nga stafi i RrGGK-s ka qenë nevoja për vizita më të shpeshta të organizatave gjatë zbatimit të projektit me qëllim të ofrimit të këshillimeve shtesë për të gjitha dokumentet që nevojiten për përmbylljen e duhur të projektit.⁹ Koordinatorja e FGK-s ka kaluar 30% të kohës jashtë Prishtinës dhe 70% të kohës në Prishtinë. Vlerësuesit kanë vërejtur se koha në Prishtinë është kaluar në mënyrë efikase; një kohë e dukshme e kaluar në Prishtinë ka qenë produktive për bashkëveprim mes stafit të RrGGK-s dhe përfitueseve regionale (përfitueset e granteve të FGK). Stafi i RrGGK-s ka ofruar këshilla për 36 organizata anëtare të RrGGK-s në avokim, hartimin dhe përgatitjen e dokumenteve të propozimeve, janë bërë 22 vizita monitoruese dhe kanë pasur 830 kontakte me anëtarët përmes telefonit, postës elektronike apo takime sipas kërkesave të anëtarëve. Për më tej, janë mbajtur 5 punëtori për ngritjen e kapaciteteve (janë nevojitur më

⁷Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës. (2013). “Grante të Vogla, Mundësi të Mëdha.”

⁸Stafi përkatës i FGK përfshin Drejtorin Ekzekutiv të RrGGK-s (39%), Koordinatorin e FGK (85%), Menaxherin e Programit (10%+37% kosto indirekte), Zyrtari për Marrëdhënie me Publikun (50%), Asistenti I Projektit (100%).

⁹Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës. (2014). “Raporti i Progresit të Projektit”. Raporti Vjetor i Progresit dorëzuar Agjencisë Austriake për Zhvillim më 28 shkurt 2014.

shumë punëtori se sa është pritur për shkak të kapaciteteve të dobëta të përfitueseve të granteve në menaxhimin e projekteve dhe në avokim), ku sesionet individuale të këshilldhënies kanë qenë vendimtare në mënyrë që anëtarëve të RrGGK-s t'iu ofrohet mbështetje shtesë në lidhje me njohuritë dhe shkathtësitë e tyre të fituara.¹⁰ Stafi i RrGGK-s është avancuar mjaft shumë sa i përket zhvillimit të mjeteve për menaxhimin e projektit për ngritjen e kapaciteteve brenda anëtarëve të RrGGK-s.

Sa i përket menaxhimit të bazës së të dhënave, stafi i RrGGK-s kryesisht ka përdorur Microsoft Excel për regjistrimin e informatave dhe nxjerrjen e raporteve. Një gjë e tillë ka marrë kohë. Softueri i hartuar rishtas i Sistemit për Menaxhimin e Grantave (GMS) do ta bëjë më efikas procesin e menaxhimit të të dhënave të FGK-s dhe do të kursej kohën e stafit si dhe do të sigurojë që të gjitha të dhënat të jenë konsoliduar dhe të ruajtur në një vend të sigurt. Gjatë kohës së vizitave të Konsulentëve në terren, bartja e të dhënave mes dy sistemeve softuerike ishte procesuar por nuk ishte përfunduar. Vlerësuesit nuk kanë gjetur ndonjë rast tjetër të mangësive strukturale gjatë zbatimit të projektit

Asistentja e Projektit dhe Koordinatorja aktuale e FGK-s kanë filluar punën në mars 2013. Stafi i RrGGK-s është trajnuar për teknikat M&V.¹¹

Përmbledhje

Në përmbledhje të kësaj, provat tregojnë se në këtë pikë afatmesme, Fondi është duke lëvizur në mënyrë të qëndrueshme dhe në drejtimin e duhur drejt përmbushjes së qëllimeve të tij afatgjata. Ekipi i vlerësimit e pranon se në qoftë se Projekti FGK-s do ta vazhdojë atë, atëherë ai do të ketë nevojë për financim të qëndrueshëm, trajnime/mentorime të vazhdueshme në lidhje me OJQ-të dhe menaxhim të ciklit të projektit, avokimin qytetarë dhe pjesëmarrjen e grave në politikë.

Përmbledhja e gjetjeve dhe rekomandimeve është e sistemuar në seksionet e tyre - Seksioni 3 dhe Seksioni 5.

¹⁰ Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës. (2014). "Raporti i Progresit të Projektit". Raporti Vjetor i Progresit dorëzuar Agjencisë Austriake për Zhvillim më 28 shkurt 2014.

¹¹ Intervista kryesore informative me Igballe Rogova dhe Nicole Farnsworth, më 9 mars 2014.